

Zgjerim i çekuilibrave të jashtëm por me shkallë të ndryshme mes vendeve të Ballkanit Perëndimor


- Strukturat tregtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor do të preken nga një ndërthurje e goditjes në anën e ofertës, më së shumti nëpërmjet zinxhirëve globalë të vlerës (ZGV), dhe goditjes nga ana e kërkesës për shkak të recesioneve në partnerët kryesorë tregtarë.
- Dallimet midis strukturave tregtare do të ndikojnë në efektin e ngadalësimit të tregtisë.
- Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi kanë të ngjarë të pësojnë përkeqësim të deficitit të llogarisë korente për shkak të mbështetjes së madhe të eksportit të shërbimeve të lidhura me turizmin.
- Bosnja dhe Hercegovina (BH), Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë më të integruara në zinxhirët globalë të vlerës dhe do të preken kryesisht nëpërmjet rënies së eksporteve të mallrave.
- Politikat tregtare, si ulja e tarifave dhe masa të tjera për lehtësimin kufitar, do të jenë të rëndësishme për lehtësimin e pengesave imediate të shkaktuara nga pandemia dhe për të ndihmuar në rimëkëmbjen.

Dallimet midis strukturave tregtare do të ndikojnë në efektin e ngadalësimit të tregtisë.

Shpërthimi i epidemisë COVID-19 fillimisht e pengoi tregtinë nëpërmjet zinxhirëve globalë të vlerës, por goditjes e ndërthurura të kërkesës dhe të ofertës janë ato që po ndikojnë më shumë tani në tregtinë globale të mallrave dhe shërbimeve. Mbyllja e kufijve ndërkombëtarë i pengoi flukset e tregtisë globale, ndërsa masat e kufizimeve mbi popullsinë dhe bizneset e dobësuan kërkesën: të dyja këto kanë shkaktuar probleme të dhimbshme për turizmin. Shkalla e vështirësisë ekonomike dhe e ngadalësimit të tregtisë do të varet se si do të sheshohet lakorja e infektiveve nga masat në fushën e shëndetësisë dhe sa efektive do të jenë kundërpërgjigjet e politikave. Nga informacionet e tanishme dhe nga çmuarjet që u janë bërë të dhënave të sektorit të jashtëm për vitin 2020 për vendet e Ballkanit Perëndimor, duket se sa më shumë të mbështetet një vend në sektorin e turizmit dhe në sektorët e lidhur me të siç janë transporti, sidomos linjat ajrore dhe hoteleria, aq më fort goditet ai; por edhe një vend i mbështetur në tregtinë e mallrave si në sektorin automobilistik, industrial dhe metalet bazë nuk mbetet më pas.

Pra, kriza e COVID-19 është duke i cenuar arritjet e fituara nga integrimi tregtar që kanë bërë vitet e fundit vendet e Ballkanit Perëndimor. Kohët e fundit, tregtia ka pasur më shumë kontribut në të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ndërkohë që këto vende janë hapur më shumë ndaj tregtisë. Ngaqë të gjitha vendet e rajonit i kanë zgjeruar marrëdhëniet tregtare në mënyrë të njëtrajtshme, hapja e tyre ndaj tregtisë është më e lartë se mesatarja e rajonit të Europës dhe Azisë Qendrore (EAQ), paçka se më e ulët se mesatarja e vendeve Balltike dhe të Europës Qendrore, megjithëse Maqedonia e Veriut dhe Serbia e përmbushin këtë standard (Figura 1).


Figura 1. Indeksi i Hapjes Tregtare



Burimet e ndryshme të rritjes së tregtisë së mallrave dhe shërbimeve do të përcaktojnë përmasën e ndikimit në vendet e ndryshme, ku dalin dy grupime. Në Shqipëri, në Malin e Zi dhe në Kosovë tregtia e shërbimeve luan një rol shumë më të madh (Figura 2A), më së shumti për shkak të rëndësisë që ka turizmi dhe shërbimet e lidhura me të në ekonomitë e tyre. Integrimi i tyre tregtar është më i madh nga sa do të pritej nga përmasat e ekonomive të tyre, ngaqë në këto vende tregtia e shërbimeve është ose më e madhe se tregtia e mallrave (Shqipëria) ose ka kontribuar shumë më shumë në hapjen e përgjithshme ndaj tregtisë (Mali i Zi dhe Kosova), por për të tre këto vende ka të ngjarë që pandemia të jetë një faktor i rëndë negativ duke qenë se pasojat në turizëm cenojnë edhe eksportet e shërbimeve. Gjithashtu, ulje do të pësojë edhe veprimtaria e shërbimeve të tjera, sidomos në ushqim, argëtim dhe tregti me pakicë. Të gjitha këto pasoja negative përkeqësohen edhe më tej nga koha kur ka goditur kriza: pikërisht atëherë kur po fillonin përgatitjet për sezonin turistik; çka do të thotë se do të shkojë dëm edhe një sasi e konsiderueshme investimesh të lidhura me turizmin.

Në grupin tjetër janë ekonomitë e Bosnjës dhe Hercegovinës, të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë (Figura 2B), ku më i theksuar është integrimi në tregtinë e mallrave. Tregtia e këtyre vendeve është bërë edhe më e hapur nëpërmjet zgjerimit të tregtisë së mallrave kur këto ekonomi janë integruar edhe më shumë në zinxhirët globalë të vlerës. Pengesat në zinxhirët e furnizimit të shkaktuara nga ngadalësimi i prodhimit në Kinë, në Europë dhe në SHBA dhe rënia globale e kërkesës agregate e shkaktuar nga rënia ekonomike janë kanalet kryesore të transmetimit të pasojave mbi këto vende.

Figura 2. Hapja Tregtare: shërbimet dhe mallrat, 2014-2018



Burimi: WDI dhe llogaritje të personelit të Bankës Botërore


Pasojat negative nga tregtia do të ndërlikohen më tej nga ngadalësimi i pritur në BE, ku parashikimet për rritjen reale të PBB-së në 2020 e vendosin atë në shifrën -7,1 për qind (Parashikimi Ekonomik Botëror i FMN-së, prill 2020). BE-ja është partneri më i madh tregtar i Ballkanit Perëndimor. Ngaqë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë të integruar ngushtë me ekonomitë e BE-së nëpërmjet një rrjeti të ngjeshur tregtie mallrash dhe shërbimesh të ndërmjetme dhe të gatshme, disa nëpërmjet zinxhirëve globalë të vlerës, ato janë të cenueshme nga çdo pengesë që mund të ndodhë në to. Thuajse 70 për qind e eksporteve të Ballkanit Perëndimor shkojnë drejt BE-së, i cili është edhe burimi i thuajse 60 për qind të importeve të këtij rajoni. Marrëveshjet e tregtisë midis BE-së dhe vendeve të rajonit kanë nxitur edhe integrimin tregtar rajonal nëpërmjet zinxhirëve globalë të vlerës.

Maqedonia e Veriut, Serbia dhe, në një shkallë më të pakët, Bosnja dhe Hercegovina janë të integruar në një nivel më të hollësishëm në zinxhirët globalë të vlerës.

Një mënyrë se si pandemia po e pengon veprimtarinë ekonomike është nëpërmjet ndikimit që ka në zinxhirët globalë të vlerës, çka i shumëfishon efektet mbi vendet në formën e goditjeve ndaj tregtisë, prodhimit dhe tregjeve financiare. Ngaqë tregtia e cila qarkullon nëpërmjet zinxhirëve globalë të vlerës mbështetet shumë te livrimi i llojit “në momentin e kërkuar” (“just-in-time”) të komponentëve të rëndësishëm të importuar, kjo i bën këto vende sidomos të cenushme kur furnizimet ndërpriten nga karantinat rajonale, mbyllja e objekteve të prodhimit dhe vendosja e masave kontrolluese në kufij. Për këtë arsye, pasojat negative të ngadalësimit të tregtisë përkeqësohen për prodhuesit e mallrave të ndërmjetme të cilat qarkullojnë nëpërmjet zinxhirëve globalë të vlerës ngaqë mund të kalojnë kufijtë disa herë gjersa të arrijnë të kthehen në produkt të gatshëm.

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të integruar në zinxhirët globalë të vlerës nëpërmjet lidhjeve të kundërta (Figura 3). Raporti i Zhvillimit Botëror 2020 konstaton se vendet të cilat specializohen në prodhim si Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut kryesisht integrohen në zinxhirët globalë të vlerës nëpërmjet lidhjeve me hallkat e poshtme të zinxhirit të furnizimit në ekonominë globale: eksportet e tyre, si produktet automobilistike apo elektronike, kanë nevojë për sasi të konsiderueshme pjesësh të importuara nga jashtë vendit. Vende të tilla janë më të predispozuar të vuajnë nga goditjet e anës së ofertës. Ndërsa goditjet e anës së kërkesës prekin në mënyrë më akute vendet që mbështeten në lidhjet me hallkat e sipërme të zinxhirit të furnizimit, siç janë eksportuesit e mallrave bazë, për të cilat bie kërkesa nga qendrat prodhuese kur këto reagojnë ndaj pamundësisë për të eksportuar mallrat e gatshme që prodhojnë. Deri tani tregtia dhe prodhimi industrial kanë rënë më së shumti në vende me lidhje të forta me hallkat e sipërme të zinxhirit të furnizimit, çka tregon se faktori kërkesë i krizës ekonomike të COVID-19 ka qenë më e rëndë se faktori ofertë, duke i mbrojtur deri diku vendet e Ballkanit Perëndimor.


Figura 3. Lidhjet me hallkat e poshtme dhe hallkat e sipërme të zinxhirit të furnizimit, Ballkani Perëndimor dhe vendet e tjera të EAQ-së, % e eksporteve



Burimi: Eora dhe llogaritje të personelit të Bankës Botërore.

Nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, po të mbajmë parasysh strukturën e ekonomive të tyre, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë më shumë të integruara në zinxhirët globalë të vlerës se vendet e tjera. Për shembull, tregtia e mallrave të ndërmjetme industriale e lidhur me zinxhirët globalë të vlerës (Figura 3) në Maqedoninë e Veriut zë 50 për qind të tregtisë së mallrave gjithsej (mbi 25 për qind të PBB-së) dhe në Serbi është 40 për qind (rreth 14 për qind e PBB-së). Në të dy rastet, rreth dy të tretat e kësaj tregtie bëhet me vendet e BE-së, sidomos me Gjermaninë, me Italinë dhe me Britaninë e Madhe, në kuadër të zinxhirëve rajonalë europianë të vlerës (Figura 4). BE-ja është rajoni i cili është prekur më shumë nga pandemia dhe objektet prodhuese në këto vende janë mbyllur; kjo do të ketë pasojë ngjithëse në importin e pjesëve industriale dhe të komponentëve, si edhe në eksportin e mallrave nga vendet e Ballkanit Perëndimor.


Figura 4. Tregtia e faktorëve të ndërmjetëm të prodhimit industrial, % e PBB-së



Burimi: Databaza e Statistikave Tregtare e OKB-së dhe llogaritje të personelit të Bankës Botërore.

Eksporti i produkteve të prodhimit të lidhura me zinxhirët rajonalë të vlerës ka gjasë të jetë më i prekuri. Ngadalësimi i thellë i parashikuar për BE-në do të prekë vendet të cilat kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në zinxhirët rajonalë të vlerës të Europës, sidomos Serbinë, Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjën dhe Hercegovinën, nëpërmjet kanalit të tregtisë së mallrave. Në veçanti, sektori i prodhimit do të vuajë nga 1) pengesat ndaj prodhimit në anën e ofertës; 2) efektet ngjithëse në zinxhirin e furnizimit, të cilat do t'i amplifikojnë goditjet e drejtpërdrejta mbi ofertën për vendet më pak të prekura; dhe 3) pengesat nga ana e kërkesës për shkak të rënies së kërkesës agregate (pra, recesionit), vonesat në blerje të llojit “të presim e të shohim çfarë do të ndodhë” nga ana e konsumatorëve dhe vonesat në investimet nga bizneset. Në veçanti, më fort do të goditen sektorët që prodhojnë makineri dhe pajisje elektrike, makineri dhe pajisje mekanike, automobila, hekur e çelik, mobilie dhe orendi dhe veshje-konfeksione, të cilët janë më të integruarit në tregtinë përpunuese nëpërmjet zinxhirëve globalë të vlerës me Europën (Figura 5). Për shembull, në mes të muajit mars “Volkswagen”, “Audi”, “Peugeot”, “Ford” dhe prodhues të tjerë të mëdhenj e ndërprejnë prodhimin në Europë, duke e ulur kështu kërkesën për pjesë dhe elemente automjetesh të prodhuara në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, eksportet e qarqeve elektronike nga Maqedonia e Veriut, 89 për qind e të cilëve shkojnë në Gjermani, eksportet e metaleve nga Bosnja dhe Hercegovina (që përdoren më së shumti në sektorin automobilistik) dhe të orendive po nga ky vend, dhe eksportet e makinerive dhe pjesëve të makinerive, të gomë-plastikës dhe të mobilieve nga Serbia përballen tashmë me ndërprerje në anën e zinxhirëve të ofertës dhe me rënie të kërkesës për produkte. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të vuajnë edhe për shkak se eksportet e produkteve të gatshme mbështeten shumë në tregun italian, i cili ka pësuar goditjen më të madhe në Europë.

Figura 5. Disa eksporte të përzgjedhura në tregtinë përpunuese, % e tregtisë gjithsej




Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave e Eurostatit për tregtinë ndërkombëtare të mallrave dhe llogaritje të personelit të Bankës Botërore.

Rënia e madhe e sasisë së mallrave të eksportuara nga Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia amortizohet nga një rënie e ngjashme në sasi e importeve të tyre, çka pasqyron vlerën relativisht të ulët të shtuar të eksporteve të këtij rajoni. Megjithëse këto tri ekonomi do të goditen rëndë nga kriza, efekti negativ në pozicionin e tyre të jashtëm mund të jetë disi më i vogël se në tri vendet e tjera të rajonit, ngaqë do të bien edhe importet, duke qenë se janë vende që kryesisht importojnë për të eksportuar, kështu që rimëkëmbja duhet të jetë më e lehtë pasi të ketë rifilluar prodhimi dhe pasi të jenë rikthyer në funksionim zinxhirët globalë të vlerës, sidomos në BE-.

Çekuilibrat e jashtëm do të rriten më shumë në Shqipëri, në Kosovë dhe në Malin e Zi, vende këto të cilat mbështeten më shumë në eksportet e shërbimeve turistike

Parashikohet që Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi të kenë rritjen më të madhe të deficitit të llogarisë korente për shkak të mbështetjes së madhe te eksportet e shërbimeve të lidhura me turizmin (Figura 5). Vendi më i prekur do të jetë Shqipëria, ku deficitin e llogarisë korente çmohet se do të arrijë 12 për qind të PBB-së në 2020, 4,3 pikë përqindjeje më shumë se në vitin 2019. Kjo do të shkaktohet jo vetëm nga pakësimi i të ardhurave të sektorit të turizmit dhe pasojave të tërmetit, por edhe nga rënia e eksporteve të sektorit minerar dhe prodhimit. Në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria është vendi më i ekspozuar ndaj Italisë, që merr thuajse një të dytën e eksporteve të Shqipërisë. Deficiti i llogarisë korente i Kosovës do të përkeqësohet për shkak të rënies së eksporteve të shërbimeve drejt diasporës dhe të dërgesave private nga jashtë, ndërsa Mali i Zi preket veçanërisht nga rënia drastike e turizmit, që zë më shumë se 20 për qind të PBB-së. Për shkak të lidhjes me zinxhirët globalë të vlerës, rritja e deficitit të llogarisë korente në Serbi, në Maqedoninë e Veriut dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë do të jetë më pak ngaqë rënia e eksporteve do të gjejë pjesërisht kompensim në një rënie të krahasueshme të importeve, meqë këto vende më së shumti “importojnë që të eksportojnë” në kuadër të pjesëmarrjes në zinxhirët globalë të vlerës. Deficiti i përgjithshëm i llogarisë korente për rajonin në tërësi çmohet se do të zgjerohet nga 6,2 për qind që ishte në vitin 2019, në 7,4 për qind në vitin 2020.

Figura 6. Bilanci i llogarive korente, 2009-2020ç, % e PBB-së




Burimi: Autoritetet kombëtare dhe llogaritje të personelit të Bankës Botërore

Rënia e pritur e dërgesave private nga jashtë si pasojë e krizës së COVID-19 do ta rritë tryshninë me deficitin e llogarisë korente të krijuar nga rënia e eksporteve. Për shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, dërgesat private nga jashtë përbëjnë një burim thelbësor për financimin e deficitit tregtar. Në një nivel mesatar prej 6,1 për qind të PBB-së gjatë pesë viteve të fundit, kontributi i tyre në shumicën e vendeve të rajonit ka qenë i konsiderueshëm. Në vitin 2020, kjo prirje nuk ka të ngjarë të vijojë. Ekonomitë e Austrisë, Gjermanisë, Greqisë, Italisë e të Zvicrës, që janë edhe burimet parësore të dërgesave private, kanë pësuar goditje të rënda nga kriza e COVID-19. Emigrantët të cilët kanë humbur vendin e punës nuk mund t’u dërgojnë para familjeve të tyre dhe ata të cilët e kanë ende vendin e punës fitojnë më pak ngaqë punojnë me orar të shkurtuar. Sipas çmuarjeve, dërgesat private në rajon do të bien në vitin 2020 me 0,5 për qind të PBB-së, çka do të jetë e dhimbshme ngaqë marrësit e tyre janë shpesh ndër më të cenueshmit në popullsi dhe do të kenë më pak para për konsum. Dhe për Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Serbinë çmohet se dërgesat private do të bien edhe më shumë, 0,8 deri në 1,1 për qind të PBB-së.

Investimet e huaja të drejtpërdrejta në rajon pritet të jenë më të ulëta në 2020 në krahasim me 2019, me 1,5 pikë përqindjeje, çka do të cenojë aftësinë e vendeve për të financuar deficitin e llogarisë korente (Figura 7). Ndërkohë që goditja nga ana e ofertës ndaj tregtisë dhe zinxhirëve globalë të vlerës mund të kapërcehet me heqjen e masave kufizuese në Europë, pasojat e tronditjeve në anën e kërkesës mund të zgjasin më shumë. Shumica e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në rajon kanë shkuar në sektorin automobilistik, atë të lëndëve bazë, të pajisjeve elektrike dhe të turizmit: të gjithë këta sektorë që janë goditur më rëndë në botë. Prandaj shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në këta sektorë kanë gjasa t’i vonojnë vendimet për investimet, me rënien e të fitimeve të shkaktuar nga rënia e kërkesës. Sipas UNCTAD, flukset globale të investimeve të huaja të drejtpërdrejta në 2020 pritet të bien 5 deri 15 për qind, në nivelin më të ulët të tyre pas vitit 2008-2009. Ballkani Perëndimor nuk përbën përjashtim: IHD mesatare në këtë rajon pritet të bien nga 5,1 për qind e PBB-së që qenë në 2019, në 3,6 për qind në 2020 (niveli më i ulët që prej vitit 2005). Rëniet më të mëdha në krahasim me vitin 2019 priten në Malin e Zi (4 pikë përqindjeje), në Serbi (3 pikë përqindjeje) dhe në Maqedoninë e Veriut (1,2 pikë përqindjeje). Rënia pritet të jetë shumë e vogël në Shqipëri dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa për Kosovën nuk pritet të ketë rënie. Megjithatë, me shtrëngimin tashmë të tregjeve të kapitalit, nuk mund të përjashtohet përkeqësimi i mëtejshëm në besimin e investitorëve. Një përkeqësim i pandemisë mund të amplifikonte më tej flukset dalëse të kapitalit prej tregjeve të reja siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe mund të frenonte investimet, një rrezik serioz për Malin e Zi, Shqipërinë dhe Serbinë, të cilat mbështeten në IHD për financimin e deficiteve të tyre të mëdha të llogarisë korente.

Figura 7. Raporti neto IHD/PBB, ndryshim në %



Burimi: Autoritetet kombëtare dhe llogaritje të personelit të Bankës Botërore.

Bilanci i pagesave do të ketë nevojë për vëmendje serioze për t'i "balancuar" deficitet e rritura tregtare me IHD-të e zvogëluara. Gjatë viteve të fundit, rritja e IHD-ve ka financuar deficitin e llogarisë korente në rajon, por në kushtet e tanishme të rënies së IHD-ve, financimi i deficitit të llogarisë korente do të duhet të plotësohet me burime të tjera. Teksa vendet i kthehen rritjes së financimit nga burimet ndërkombëtare, më së shumti nga institucionet financiare ndërkombëtare (sidomos nga KE-ja, FMN-ja apo Banka Botërore), kjo nga njëra anë do ta lehtësonte trysninë mbi deficitin e llogarisë korente, por nga ana tjetër do të kishte rrjedhoja për borxhin e përgjithshëm të jashtëm dhe sidomos për borxhin publik të qeverive. Viti 2020 i gjen të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor me borxh publik të rritur: mesatarisht borxhi i jashtëm publik pritet të rritet me 4,7 pikë përqindjeje të PBB-së. Rritjet më të mëdha priten në Serbi, me 5,8 pikë përqindjeje, dhe në Maqedoninë e Veriut, me rreth 5,1 pikë përqindjeje; për vendet e tjera, kjo rritje do të luhet nga 3,6 deri në 4,9 pikë përqindjeje të PBB-së.

Hyrja në tregtinë e lirë të mallrave dhe shërbimeve do të jetë e nevojshme për të kufizuar ndikimin imediat të pandemisë dhe për të ndihmuar në rimëkëmbje.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë vepruar tashmë për t'i zbutur ndërprerjet në transportin dhe tregtinë e mallrave me miratimin e konceptit të korsisë së gjelbër nga Sekretariati i CEFTA-s¹. Koncepti filloi më 13 prill 2020 në pikat e përcaktuara të kalimit kufitar, të cilat përmbushin kriteret specifike. Siç është deklaruar edhe nga Sekretariati, korsitë e gjelbra do të hapen për të gjitha mallrat dhe trafiku do të lëvizë në çdo orë të ditës e të natës. Pikat e kalimit kufitar të përzgjedhura janë ato ku procedurat doganore dhe procedurat e tjera administrohen në mënyrë më efikase. Prioritet u është dhënë ushqimeve thelbësore, produkteve foragjere dhe materialeve mjekësore të përcaktuara nga Organizata Botërore e Doganave. Lista e mallrave thelbësore mund të rivlerësohet dhe të modifikohet, si edhe mund të lejohen edhe pika të tjera të kalimit kufitar me plotësimin e kriterëve nga ana e tyre. Përdoret Sistemi i Shkëmbimit Elektronik të të Dhënave (SEED) për të përshpejtuar zhdoganimin e mallrave më thelbësore. Disa vende i kanë ende në zbatim kufizimet e vendosura më herët mbi disa produkte të lidhura me COVID-19 (Tabela 1) por pritet që këto vende të vendosin t'i heqin këto ndalime, në frymën e konceptit të korsive të gjelbra dhe të angazhimit për tregti të hapur.

Tabela 1: Ndalimi i eksportit të produkteve mjekësore dhe ushqimore

¹ CEFTA është Zona Europiane-Qendrore e Tregtisë së Lirë; përbëhet nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Vendi	Produkte ushqimore	Materiale konsumi mjekësore	Pajisje mjekësore	Medikamente ose barna	Data e fillimit të zbatimit	Data e heqjes	Lloji i masës
Shqipëria	Jo	Po	Po	Po	3/11/2020		Kufizuese
Maqedonia	Po	Jo	Jo	Jo	3/20/2020	4/30/2020	Kufizuese
Serbia	Po	Po	Po	Jo	3/14/2020	4/14/2020	Kufizuese
Serbia	Jo	Jo	Jo	Po	3/16/2020	4/16/2020	Kufizuese
Serbia	Po	Po	Jo	Jo	3/17/2020	4/14/2020	Kufizuese
Serbia	Jo	Po	Jo	Jo	3/17/2020		Liberalizuese
Serbia	Po	Po	Jo	Jo	3/21/2020		Liberalizuese
Serbia	Po	Jo	Jo	Jo	3/24/2020	4/14/2020	Kufizuese
Serbia	Po	Po	Jo	Jo	3/27/2020		Liberalizuese

Burimi: OBT dhe qeveritë kombëtare.

Nevojiten masa për thjeshtimin e procedurave tregtare dhe për lehtësimin e tregtisë në kufi, për të ulur ndikimin e krizës dhe për të mbështetur rimëkëmbjen. Mbajtja e shërbimeve të transportit dhe logjistikës përgjatë korridoreve kryesore do të jetë me rëndësi për të marrë në vlijmësi mallra dhe shërbime thelbësore. Për t'i plotësuar reformat e politikës tregtare dhe masat e lehtësimit të tregtisë në periudhën afatmesme duhen përmirësuar marrëveshjet për kalimin tranzit, përsheptimi i lëvizjes përgjatë korridoreve të mallrave mjekësore të lidhura me pandeminë dhe i produkteve ushqimore dhe energjetike dhe ruajtja e masave kontrolluese adekuate të shëndetit publik. Politikat tregtare, si ulja e tarifave dhe masat e tjera të lehtësimit të kalimit kufitar, mund t'i minimizojnë problemet e shkaktuara nga pandemia.

Politika imediate për lehtësimin e tregtisë, menaxhimin e risqeve dhe lehtësimin e qarkullimit të mallrave mjekësore thelbësore:

- **Pezullimi i tarifave për materialet kyçe mjekësore/sanitare.** Të thjeshtohet procesi i marrjes së licencave për produktet mjekësore dhe të mendohet hapja e tregtisë së shërbimeve të lidhura me shëndetësinë për t'i ndihmuar vendet t'i japin zgjidhje krizës dhe të heqin një pjesë të trysnisë mbi shërbimet shëndetësore vendase;
- **Ulja e taksave të importit dhe eksportit,** sidomos e tarifave mbi ushqimet dhe mallrat e tjera të domosdoshme, në kuadër të një programi për të mbështetur të ardhurat dhe veprimtarinë e bizneseve.
- **Ulja e tarifave për materialet mjekësore dhe produktet ushqimore** për të mbështetur konsumin e artikujve thelbësorë dhe për të kufizuar ndikimin negativ të më të varfrit.
- **Miratimi i masave për të lehtësuar tregtinë e sigurt ndër-kufitare, në veçanti për të siguruar qarkullimin e produkteve thelbësore mjekësore dhe ushqimore dhe më në përgjithësi për të lehtësuar vijimësinë e bizneseve** nëpërmjet 1) mbrojtjes së punonjësve në front në kufi; 2) dhënies përparësi trajtimit me bazë riskun të dërgesave të ndihmës humanitare; 3) mbështetjes së përdorimit të intensifikuar të menaxhimit të riskut për të lehtësuar lëvizjen e transportit të mallrave me risk të ulët dhe për të minimizuar akumulimin e vonësve në rrugët tregtare të mallrave.

Politika imediate për lehtësimin e trysnisë mbi operatorët e eksport-importit:

- Ulja e barrës tatimore dhe administrative mbi importuesit dhe eksportuesit
- Dhënie përparësi trajtimit me bazë riskun të dërgesave të ndihmës humanitare.
- Mbështetja e përdorimit të intensifikuar të menaxhimit të riskut për të lehtësuar lëvizjen e transportit të mallrave me risk të ulët dhe për të minimizuar akumulimin e vonësve në rrugët tregtare të mallrave.

Kur kundërpërgjigjet imediate ndaj krizës kalojnë në fazën e rimëkëmbjes, duhen menduar politika afatmesme, si:

- Nxitja e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm të agjencive kufitare me qëllim lehtësimin e tregtisë në bazë të parimeve të ekuivalencës, njohjes reciproke dhe sistemeve të barasvlershme
- Sigurimi që masat dhe veprimtaritë kufitare të jenë transparente në mënyrë që operatorët logjistikë dhe tregtarët të jenë më shumë në gjendje t'u dalin përpara problemeve dhe të menaxhojnë flukset tregtare.
- Analizimi i shpejtë dhe eliminimi i çdo procesi të mbivendosur apo të panevojshëm (kërkesat ligjore për shkresat, licencimi etj.) të cilat nuk janë të nevojshme por pengojnë lëvizjen e artikujve të rëndësishëm dhe me jetë të shkurtër.